

SPECIALE: INTERVISTË ME HENRY H. PERRITT, PROFESOR I DREJTËSISË NË "CHICAGO – KENT COLLEGE OF LAW", ISH-PJESËTAR I STAFIT TË SHTËPISË SË BARDHË NË KOHËN E PRESIDENTËVE FORD DHE CLINTON

# PERRITT: JAM I HABITUR ME AGIM ÇEKUN

## AI ËSHTË DASHUR TA PASTROJË QEVERINË DHE DUHET TA PASTROJË OSE TË JAPË DORËHEQJE.

EPOKA  
ERE

ARSIM SINANI

**Prishtinë, 20 gusht** – Unë nuk pres ndonjë marrëveshje. Megjithatë bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë të vlefshme për dy arsye, kështu i ka deklaruar "Epokës së re" në një intervistë ekskluzive nëpërmjet telefonit, Henry H. Perritt, profesor i Drejtësisë në "Chicago – Kent College of Law". Perritt, ish-pjesëtar i stafit të Shtëpisë së Bardhë në kohën e presidentëve Ford dhe Clinton, ka thënë se arsyeja e parë, e këtyre bisedimeve është se ato i japin palës kosovare mundësinë që të dëshmojnë profesionalizmin dhe angazhimin e tyre në procesin diplomatik dhe e bëjnë palën serbe që të duket keq për disa paragjykimet dhe mite për Kosovën. "Ky kontrast do të ndihmojë përmirësimin e imazhit të Kosovës në botë dhe do të krijojë përkrahje për pavarësi", ka thënë ai.

Arsyeja e dytë, sipas profesor Perritt, është se bisedimet edukojnë çdokënd për t'u marrë me çështjet konkrete. "Do të dëshiroja që sa më shumë vëmendje t'u kushtohet çështjeve ekonomike, si dhe atyre të decentralizimit dhe të drejtave të njeriut. Për shembull pas statusit final duhet të ekzistojë një mekanizëm ndërkombëtar që do të siguronte se gjykatat në vendet e tjera do të respektojnë vendimet e marra nga Gjykata Supreme e Kosovës rreth privatizimit. Unë ia kam shprehur rëndësinë e kësaj edhe presidentit Sejdiu, kryeministrit Çeku, Ramush Haradinajt dhe Hashim Thaçit, dhe shpresoj se ata do t'i japin prioritet kësaj në bisedimet për çështjet ekonomike. Në të kundërtën investitorët e ndërmarrjeve private do të përballëshin me padi që do të ngriheshin në mbarë botën, dhe kjo do të pamundësonte krijimin e vendeve të reja të punës dhe do të dekurajonte investimet", i ka deklaruar Perritt nëpërmjet telefonit "Epokës së re".

### Takimi i "elefantëve" dhe negociatat në Vjenë

**EPOKA E RE:** Si e vlerësoni ju takimin e "elefantëve" që ndodhi kohë më parë në Vjenë. Mendoni se po fillon ta kuptojë pala serbe se po e humb Kosovën?

**Perritt:** Takimi i ashtuquajtur i "elefantëve" ka qenë inkurajues pasi deri më tash ka treguar se komuniteti ndërkombëtar është i vendosur që të arrijë deri të një vendim për

statusin para fundit të këtij viti. Unë jam i shqetësuar për disa gjëra që do të mund të vononin zgjidhjen e statusit përfundimtar, apo do ta dërgonin atë në një drejtim të gabuar. Së pari, mundësia që konfliktet në Irak, Izrael dhe Liban të marrin vëmendjen kryesore të politikës amerikane, dhe të fuqizohet ndikimi i Rusisë në angazhimin e saj për të bllokuar pavarësimin e Kosovës. Deri tani një gjë e tillë nuk ka ndodhur por vazhdon të jetë një shqetësim. Ky rrezik e bën edhe më të rëndësishëm marrjen e një vendimi përfundimtar dhe Kosova duhet të bëhet e pavarur para fundit të këtij viti. Madje edhe implementimi i pavarësisë do të kërkojë disa muaj në vitin ardhshëm. Së dyti, ekziston

shumë më mirë nëse do të shkëputeshin nga kontrolli i Beogradit. Liderët politik të Kosovës duhet të bëjnë gjithçka që të dëshmojnë se pjesëmarrja e serbëve në proceset politike në Kosovë do të prodhonte beneficione për serbët e Kosovës.

**EPOKA E RE:** Profesor cili do të jetë epilogu i këtyre bisedimeve që po zhvillohen në Vjenë?

**Perritt:** Unë jam ende optimist që komuniteti ndërkombëtar do ta pranojë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës para fundit të këtij viti. Kjo mund të ndodhë përmes një rezolute të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo edhe përmes njohjes formale të pavarësisë së Kosovës nga Shtetet e

**Ahmet Shala është një hero për durimin dhe për drejtimin këmbëngulës të privatizimit. Zgjedhja e Enver Hasanit si rektor i Universitetit të Prishtinës është një gjë e mrekullueshme. Ai është njeriu i duhur për të filluar ringritjen e Universitetit të Prishtinës**

mundësia që propaganda agresive serbe në Shtetet e Bashkuara dhe Evropën perëndimore mund të shtyjë opinionin publik që të mbajë qëndrim kundër pavarësisë së Kosovës. Deri më sot një gjë e tillë nuk është vërejtur të ketë ndodhur, edhe për arsyen se propaganda ka qenë aq ekstreme e bazuar në racizëm dhe urrejtje fetare ndaj popullit shqiptar të Kosovës.

Si duket politikanët nacionalistë ekstremë në Serbi e bëjnë të pamundshme që liderët serbë të pajtohen me pavarësinë e Kosovës. Megjithatë janë inkurajues disa zëra serbë janë ngritur për të thënë të vërtetën: se Serbia e ka humbur Kosovën. Gjithashtu është për t'u përshëndetur që liderët serbë të Kosovës kanë filluar të vënë në pikëpyetje vijën e ashpër të Beogradit. Ka vite që politika e Beogradit nuk është në interesin e serbëve të Kosovës. Ata do të ishin

Bashkuara, Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Italia dhe fuqitë e tjera të mëdha, pa një rezolutë të Këshillit të Sigurimit. Një rezolutë e pasuar nga njohja formale do të ishte edhe më e mirë. Në të kundërtën Serbia do të mund të pretendojë për vite me radhë se Kosova është ende formalisht pjesë e Serbisë sipas Rezolutës 1244. Edhe nëse Kosova pavarësohet këtë vit, me siguri se një formë e vëzhgimit ndërkombëtar do të jetë e pranishme. Unë shqetësohem se çfarë do të jetë kjo formë, e edhe kosovarët duhet të shqetësohen për këtë gjë. Do të ishte e lehtë për komunitetin ndërkombëtar që të strukturojë vëzhgimin e institucioneve politike të Kosovës në atë mënyrë që të dukej si UNMIK, por me një emër tjetër, apo ngjashëm siç është rasti i Bosnjës. Që të dyja këto zgjidhje nuk janë të pëlqyeshme. Për sa kohë që politika kosovare do

**Presidenti Sejdiu, kryeministri Çeku, Hashim Thaçi e Veton Surroi kanë bërë një punë të shkëlqyer në muajt e fundit me fjalimet dhe deklaratat e tyre publike, duke ndihmuar në edukimin e popullit të Kosovës për nevojën e Kosovës për pavarësi dhe kapacitetin e liderëve për të qeverisur një Kosovë të pavarur, duke respektuar të drejtat e njeriut. Jam i bindur që edhe Ramush Haradinaj do të bënte të njëjtën gjë**

### KUSH ËSHTË PROFESORI AMERIKAN HENRY PERRITT

HENRY H. (HANK) PERRITT, Jr. është profesor i drejtësisë në "Chicago-Kent College of Law". Është autor i më shumë se 70 artikujve dhe 15 librave në fushën e drejtësisë. Ka shërbyer në administratën e presidentit Clinton në detyra të rëndësishme në stafin e tij. Gjatë administratës së presidentit Ford ka qenë pjesë e stafit të Shtëpisë së Bardhë. Perritt ishte kandidat i demokratëve për Shtëpinë e Përfaqësuesve të Kongresit amerikan në zgjedhjet e vitit 2002. Ka qenë pjesë e Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara. Aktualisht është profesor në Universitetin e Çikagos. Është një mik i madh i shqiptarëve dhe i Kosovës. Ka bërë shumë vizita në Kosovë dhe e njeh mjaft mirë aktualitetin shqiptar këtu.

të jetë e gjymtuar, liderët politik kosovarë do të mund t'i ikin përgjegjësisë duke fajësuar administratën ndërkombëtare, ndërsa administrata ndërkombëtare do t'i ikë përgjegjësisë duke fajësuar liderët kosovarë. Kjo ka ndodhur në këto shtatë vite, dhe rezultatet kanë qenë të këqija. Kriza energjetike vazhdon. Nuk ka plane për krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin ekonomik. Korrupsioni vazhdon të jetë i pakutuar dhe i pandëshkuar. Populli i Kosovës meriton një ambient politik e ekonomik ku liderët e zgjedhur do të duhet të prodhojnë rezultate, apo në të kundërtën të humbin postet e fituara me votë. Kjo do të thotë që komuniteti ndërkombëtar duhet të hapë rrugën dhe politikanët kosovarë të triumfojnë, apo të dështojnë. Populli i Kosovës duhet të shfaqë pakënaqësitë në kutitë e votimit. Partitë politike dhe kandidatët duhet të zhvillojnë fushatë me propozime konkrete për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës, dhe jo të tregojnë se ata e duan pavarësinë dhe të kritikojnë administratën ndërkombëtare. Le të fillojmë të zgjidhim probleme të tjera.

### Decentralizimi dhe Mitrovica

**EPOKA E RE:** Çka mendoni lidhur me decentralizimin në Kosovë, çka prisni ju?

**Perritt:** Decentralizimi është i nevojshëm, për arsye simbolike dhe në mënyrë që të krijojë siguri për serbët dhe minoritetet e tjera, se ata nuk do të jenë gjithmonë të mbivotuar nga institucionet politike kosovare. Propozimi i fundit i palës kosovare është i pëlqyeshëm, dhe unë mendoj se atij mund t'i bëhen edhe disa ndryshime. Në anën tjetër gjithkush duhet të kundërshtojë lidhjen horizontale mes komunave serbe dhe Beogradit. Komunitat nuk duhet të kenë marrëdhënie diplomatike me vende të tjera. Për më tepër Kosova nuk mund të qeveriset me efektivitet nëse pushteti është

EPOKA  
ERE

Botues: Muhamet MAVRAJ • Redaktorë përgjegjës: Lulëzim ETEMAJ e Xhevdet FETAHU • Redaktorë: Demir RESHITI (Lajmet) • Naim ZEQRIRI (Siguria&Ekonomia) • Arsim SINANI (Maqedoni) • Redaktor teknik - Shkëmbim KRASNIQI • Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (tel: 044 127 434, e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com) • Arbenita KAMBERI (Marketing) • Fotoreportere: Rabie Bala • e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com & mm\_epokaere@yahoo.com • http://www.epokaere.com • ADRESA: Prishtinë, përballë Selisë Qendrore të UNMIK-ut

**Jam i habitur se si kryeministri Çeku, një njeri i fortë, me një përkrahje të madhe nga opinioni publik, deri më tani nuk ka bërë asgjë për të mbajtur zotimin se do të pastrojë qeverinë dhe do të kërkojë përgjegjësi nga ministrat. Nëse dy partitë e koalicionit nuk e lejojnë atë që të veprojnë, ai duhet të japë dorëheqje. Ose duhet të vazhdojë të bëjë atë që mendon se është e drejtë dhe të bëjë që partitë e koalicionit ta largojnë atë. Nëse partitë e koalicionit duan të vazhdojnë të kenë përkrahjen e opinionit publik, duhet t'i japin më shumë hapësirë kryeministrit që të qeverisë.**

shumë i decentralizuar. Zyrtarët e zgjedhur të Prishtinës duhet të kenë fuqi të mjaftueshme legislative dhe ekzekutive në të gjithë Kosovën për të pasur rezultate në zhvillimin ekonomik, të drejtat e minoriteteve dhe sundimin e ligjit, dhe të jenë përgjegjës për këto. Kur pushteti është shumë i decentralizuar, nuk ka qeverisje me përgjegjësi.

**EPOKA E RE:** Një çështje e hapur po mbetet ende qyteti i ndarë i Mitrovicës si do të zgjidhet ky problem?

**Perritt:** Nuk do të zgjidhet shpejt, por përparime mund të bëhen duke shkuar sipas sugjerimeve të ESI dhe Verena e Gerald Knaus, të cilët vazhdimisht bëjnë analiza të mira për Kosovën.

#### Washingtoni për Kosovën dhe puna e liderëve të Kosovës

**EPOKA E RE:** Cili është opinioni publik në Washington për Kosovën?

**Perritt:** Vëmendja e Uashingtonit nuk është në Kosovë. Vëmendja është në Afganistan, Irak, Izrael, Korenë e Veriut dhe Iran. Të paktë janë politikanët që janë të përqendruar te Kosova. Gjithsesi, administrata e Bushit (unë jam demokrat dhe kam vërejtje të shumta për politikën e administratës së tij) ka bërë një punë shumë të mirë deri më tani. Ka angazhuar disa nga njerëzit e tij më të mirë në Departamentin e Shtetit në procesin e statusit final të Kosovës. Kjo administratë vazhdon të insistojë që të ketë një zgjidhje përfundimtare të statusit para fundit të këtij viti. Shpresoj që ky angazhim do të vazhdojë dhe do të intensifikohet. Miqtë e Kosovës në Uashington dhe në të gjithë Shtetet e Bashkuara duhet të ndihmojnë më shumë Këshillin Kombëtar Shqiptaro-Amerikan. Zëri i tyre është dëgjuar rrallë, ndërsa kemi një makineri propagandistike serbe që regullisht jep mesazhe antishqiptare dhe kundër pavarësisë së Kosovës, në mediumet në SHBA. Shpresoj që kjo fushatë të mos e kthejë opinionin e Kongresit amerikan kundër pavarësisë së Kosovës. Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan duhet të bëjë punën e tij me më shumë agresivitet dhe efikasitet.

**EPOKA E RE:** Si e vlerësoni punën e liderëve të Kosovës?

**Perritt:** Presidenti Sejdiu, kryeministri Çeku, Hashim Thaçi e Veton Surroi kanë bërë një punë të shkëlqyer në muajt e fundit me fjalimet dhe deklaratat e tyre publike, duke ndihmuar në edukimin e popullit të Kosovës për nevojën

e Kosovës për pavarësi dhe kapacitetin e liderëve për të qeverisur një Kosovë të pavarur, duke respektuar të drejtat e njeriut. Jam i bindur që edhe Ramush Haradinaj do të bënte të njëjtën gjë, nëse lëvizjet dhe deklaratat e tij të mos ishin të kontrolluara nga UNMIK-u, dhe nëse ai do të ishte i lirë nga hija e gjyqimit të Hagës.

#### E ardhmja e Kosovës

**EPOKA E RE:** Si e shihni ju të ardhmen e Kosovës, jeni optimist për vendin tonë?

**Perritt:** Jam shumë optimist në disa drejtime, po edhe pesimist në anën tjetër. Jam optimist për krenarinë, patriotizmin dhe energjinë e popullit të Kosovës. Sidomos gjenerata e re ka ide të mira dhe është e përkushtuar për të arritur suksese. Gjendja do të përmirësohet kur sa më shumë të rinj do të marrin pozita vendimmarrëse. Edhe gjeneratat e vjetra, gjithashtu kanë shumë për të dhënë. Ahmet Shala është një hero për durimin dhe për drejtimin këmbëngulës të privatizimit. Zgjedhja e Enver Hasanit si rektor i Universitetit të Prishtinës është një gjë e mrekullueshme. Ai është njeriu i duhur për të filluar ringritjen e Universitetit të Prishtinës, që vazhdimisht ka qenë një zhgënjim për ata që janë të angazhuar për të ardhmen e ndritur të Kosovës. Jam pesimist për kapacitetet e koalicionit aktual qeverisës dhe për papërgjegjshmërinë e partive politike për të krijuar programe kundër papunësisë dhe korupsionit.

Jam i habitur se si kryeministri Çeku, një njeri i fortë, me një përkrahje të madhe nga opinioni publik, deri më tani nuk ka bërë asgjë për të mbajtur zotimin se do të pastrojë qeverinë dhe do të kërkojë përgjegjësi nga ministrat. Nëse dy partitë e koalicionit nuk e lejojnë atë që të veprojnë, ai duhet të japë dorëheqje. Ose duhet të vazhdojë të bëjë atë që mendon se është e drejtë dhe të bëjë që partitë e koalicionit ta largojnë atë. Nëse partitë e koalicionit duan të vazhdojnë të kenë përkrahjen e opinionit publik, duhet t'i japin më shumë hapësirë kryeministrit që të qeverisë.

Është e rëndësishme, jo vetëm për shkak se pavarësia do të njihet këtë vit, por edhe për shkak të zgjedhjeve të përgjithshme dhe lokale të vitit 2007, me sistemin e listave të hapura. Për një fillim të mbarë pas pavarësisë, elita politike aktuale duhet të tregojë rezultate, ose do të ndëshkohet në kutitë e votimit dhe do të zëvendësohet me fytyra të reja. Janë dy prioritetet urgjente me të cilat duhet të merret Qeveria e Kosovës së pavarur: Krijimin e vendeve të reja të punës dhe luftimin e korupsionit. Në lidhje me korupsionin unë, bashkë me një ekip studentësh po bëjmë një raport prej 75 faqesh, si iniciativë anti-korupsion në Kosovë të cilin presim ta publikojmë në javët e ardhshme.

## Tomuschat: Ndarja e Kosovës nuk është zgjidhje aq e keqe

**Berlin, 20 gusht** - Eksperti për të drejta ndërkombëtare në Universitetin e Humboldtut në Berlin, Christian Tomuschat, ka vlerësuar se bashkëngjitja e veriut të Kosovës Serbisë nuk është një zgjidhje aq e keqe, por kjo do të nënkuptonte edhe bashkëngjitjen e jugut të Serbisë, Kosovës.

"Nëse ekzistojnë pjesë të banuara me shumicë serbe, nuk e di pse nuk bën që t'i bashkohen ato Serbisë. Nga ana tjetër, pjesët e Serbisë të banuara me shumicë shqiptare do të duhej t'i bashkoheshin Kosovës. Sigurisht se ky proces do të përcillet me vështirësi të mëdha rreth përcaktimit të vijës kufitare", ka thënë Tomuschat.



## Ahtisari të martën në Kosovë

**Prishtinë, 20 gusht** - I dërguari i posaçëm i Kombeve të Bashkuara për statusin e Kosovës, Marti Ahtisari, nga e marta deri të premten do të qëndrojë në Kosovë. Zyrtari për informim nga UNOSEK-u në Vjenë, Remi Dourlot ka thënë se vizita e Ahtisarit është edhe një përpjekje në vazhdim për gjetjen e zgjidhjeve dhe arritjen e marrëveshjeve me delegacionin e Kosovës, për decentralizimin dhe çështjet që kanë të bëjnë me pakicat. Ndërkaq, të dielën, në Prishtinë ka mbërritur edhe një ekip i ekspertëve nga Zyra e Ahtisarit, i cili të hënën dhe të martën do të takohet me ekipet e Kosovës për decentralizimin dhe atë për pakicat.

**Grupi i Kontaktit ka kërkuar nga Beogradi pjesëmarrje aktive në bisedimet për statusin**

## GK i shqetësuar për gjendjen në veri të Kosovës

**"Nga të dyja palët në Kosovë pritet që të tregojnë mirëkuptim të ndërsjellë në këtë fazë të ndjeshme të bisedimeve, ndërsa nga Beogradi kërkohet që të ndikojnë në liderët e tri komunave veriore që të promovojnë aksione konstruktive dhe ta qetësojnë gjendjen", thuhet në shkresën që Grupi i Kontaktit ua ka dërguar zyrtarëve të Beogradit**

EPOKA  
ERE

DEMIR RESHITI

**Prishtinë/Bruksel/Beograd, 20 gusht** - Grupi i Kontaktit ia ka dërguar këto ditë Beogradit zyrat një shkresë, në të cilën është theksuar se muajt e ardhshëm do të jenë një shans vendimtar për Serbinë që të përfaqësojë interesat e saj në Kosovë dhe ta përmirësojë situatën e serbëve të Kosovës.

Siç njoftojnë burime nga Brukseli, Grupi i Kontaktit nëpërmjet kësaj shkrese ka falënderuar liderët serbë për pjesëmarrje në takimin e Vjenës më 24 korrik, ku janë prezantuar qëndrimet e Prishtinës dhe Beogradit lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, dhe ka njoftuar se është i kënaqur që të dyja palët i kanë paraqitur qëndrimet e tyre në mënyrë të qartë dhe duke e

respektuar njëra tjetrën.

Në shkresë është përsëritur mbështetja e plotë për kryenegociatorin Marti Ahtisari, dhe është shprehur falënderim për palët negociatore në këtë proces.

"Grupi i Kontaktit tani insiston në atë që takimet të cilat do t'i caktojë Ahtisari, të shfrytëzohen për bisedime produktive, dhe diskutimi të orientohet në çështje thelbësore e jo procedurale. Nga Beogradi kërkohet pjesëmarrje aktive në takimet kushtuar të drejtave të bashkësive etnike dhe një fleksibilitet më të madh në çështjen e decentralizimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, në mënyrë që të arrihet një zgjidhje realiste, funksionale dhe kompromisi", shkruan gazeta beogradase "Politika".

Në shkresën e dërguar nga Grupi i

Kontaktit, është shprehur shqetësim për gjendjen e krijuar në tri komunat në veri të Kosovës, para së gjithash për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të tyre me institucionet e Kosovës.

"Nga të dyja palët në Kosovë pritet që të tregojnë mirëkuptim të ndërsjellë në këtë fazë të ndjeshme të bisedimeve, ndërsa nga Beogradi kërkohet që të ndikojnë në liderët e tri komunave veriore që të promovojnë aksione konstruktive dhe ta qetësojnë gjendjen", thuhet në shkresë.

Grupi i Kontaktit, edhe këtë radhë ka përsëritur qëndrimin se pjesëmarrja e serbëve në institucionet e Kosovës, është mënyra më e mirë që ata t'i realizojnë interesat e tyre, dhe se vazhdimi i bojkotimit do të mund t'a rrezikonte të ardhmen e tyre.

## Shefi i diplomacisë slovake arrin të mërkurën në Kosovë

**Bratislavë** - Shefi i diplomacisë Sllovakisë, Jan Kubish, do të arrijë të hënën në Ballkan, në kuadër të një vizite disaditore në Serbi, Mal të Zi dhe Kosovë, ku të mërkurën do të takohet me ushtarët sllovakë që shërbejnë në

misionin paqeruajtës të KFOR-it. Temë kryesore e takimeve që Kubish do të zhvillojë gjatë kësaj vizite do të jenë marrëdhëniet e Ballkanit Perëndimor me Sllovinë, por edhe probleme tjera që kanë të bëjnë me rajonin

e Ballkanit, ka bërë të ditur Ministria e Jashtme slovake. Kubish, në postin e shefit të diplomacisë slovake ka ardhur në vend të Eduard Kukan, i cili kishte dhënë dorëheqje. (ksp)